

KRITIKA E RECENSIONE

Dr. Ismet Dërmaku, RILINDJA KOMBËTARE SHQIPTARE DHE KOLONITË SHQIPTARE TË MËRGIMIT NË RUMANI DHE NË BULLGARI. Botoi Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë 1983

Para pak kohe doli nga shtypi studimi i Ismet Dërmakut, me titullin e lartpërmendur, që paraqet edhe një kontribut shkencor në studimin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që kohëve të fundit po bëjnë historianët shqiptarë, për ta ndriçuar të kaluarën e tyre historike, e cila shpesh herë ka qenë shtrembëruar, është falsifikuar, e bile edhe është monuar nga historianët borgjez evropian dhe ballkanik. Mirëpo, të gjitha përpjekjet e tyre që kjo e kaluar të mbulohet nga pluhuri i harresës, nuk u arrit. Forcat e reja të historianëve shqiptarë, të përgatitura në shodërinë socialiste të Jugosllavisë, iu rrekën punës që nga pluhuri i harresës të nxjerrin të dhëna autentike, që dokumentojnë të kundërtën e asaj që historiografia borgjeze i kishte fabrikuar dhe i kishte publikuar, për t'i arsyetuar arspiratat e klasave sunduese.

Ismet Dërmaku, në hulumtimet e tij shumëvjeçare e këmbëngulse, ka arritur të ndriçojë në mënyrë të gjithanshme aktivitetin e dy qendrave shumë të rëndësishme të shqiptarëve jashtë atdheut, që vepruan në dobi të zhvillimit të gjuhës, kulturës dhe vetëdijës kombëtare shqiptare. Edhe pse deri tani kemi pasur disa punime që kanë trajtuar ndonjë aktivitet më të ngushtë, ose ndonjë individ, ka munguar një studim i këstillë, i gjithanshëm i thelluar, duke e përfshirë tërë aktivitetin e kolo-

nive shqiptare në këto dy vende fqinje. Autori në këtë studim pasqyron themelimin e këtyre kolonive, kushtet në të cilat filluan aktivitetin e tyre kombëtar, pengesat dhe vështirësitë në të cilat hasën dhe në të cilat u zhvillua Lëvizja kombëtare shqiptare edhe në këto dy shtete fqinje, Rumania e Bullgaria. Në saje të dhënave të shumta që ka arritur të grumbullojë, lidhur me aktivitetin patriotik të këtyre dy qendrave, autori hartoi tezën e doktoranturës, që e mbrojti në kuadër të Fakultetit Filozofik të Prishtinës. Këtë tezë të përpunuar, e të plotësuar ia botoi Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore në Prishtinë në nëntor 1983.

Ky studim i Ismet Dërmakut, është përmbledhur në 456 faqe me këtë radhitje: Parathënie, deri më f. 8, ku autori është përpjekur t'i prezentojë lexuesit, motivet, përpjekjet e vështirësitë në grumbullimin e materialit burimor, që ishte i shpërndarë në disa institucione në Rumania e Bullgaria, si dhe në arkiva personale. Poashtu, autori ka qenë i detyruar të shfytëzojë edhe raportet diplomatike të përfaqësuesve të shteteve evropiane që e përcillnin aktivitetin e kolonive shqiptare.

Kapitulli i parë titullohet: „Fillet e Rilindjes Kombëtare dhe kontributi i kolonive të mërgimit në Rumania dhe Bullgaria deri më 1881”, f. 9—80. Në këtë kapitull autori në radhë të parë bënë fjalë për mërgi-

met dhe deportimet e shqiptarëve në Bullgari. Në bazë të dhënave shënon se në Bullgari hasim familje shqiptare të vendosura që nga fillimi i shek. XIV, e ky proces ka vazhduar gjatë shekullit XVII, XVIII e XIX. Autori bënë fjalë për fshatra shqiptare që deri vonë mbanin emrin „Selo Arbanasi”. „Arbanaska mahala”. Këto koloni shqiptare në Bullgari, një kohë hapën shkolla, ku mësohej edhe gjuha shqipe. Këto koloni për kohën e anarkisë feudale në Perandorinë Osmane, u sulmuan dhe u shkatrruan nga kërxhalinjët në vitet 1794, 1798, kur një pjesë e popullsisë u detyrua të tërhiqet në Lindje dhe arriti në Vllahi e Moldavi, kurse në Bullgari mbeti një numër më i vogël. Ata që kaluan në Vllahi e Moldavi u vendosën atje dhe me kohë u veçuan disa familje që u ngritën në pozitën e sundimtarëve të këtyre krahinave, siç ishin familjet: Duka, Gjika etj.

Gjatë kohës së sundimit të Ati Pashë Tepelenës, në fund të shekullit XVIII e në fillim të shekullit XIX dhe në kohën e Tanzimatit, një numër fshatarësh shqiptarë nga Shqipëria Jugore u detvruan të braktisin atdheun e tyre dhe të mërgonin në Vllahi, Moldavi e Bullgari, duke e shtuar numrin e shqiptarëve që jetonin edhe më herët atje. Këta shqiptarë në ngjarjet e vitit 1821 kanë luajtur rol me rëndësi në Vllahi e Moldavi gjatë kryengritjes së Tudor Vladimireskut. Pos tjerësh këtu u dallua Naum Veqilharxhi, i cili në vitin 1845 do ta hartojë abetaren e parë shqipe me një alfabet të posaçëm. Me të drejtë autori konstaton se vendosja e shqiptarëve në Rumani „jo vetëm që pati rëndësi për organizimin e veprimtarisë kulturore patriotike drejt emancipimit dhe çlirimit kombëtar, por kjo lëvizje la edhe gjurmë të thella në historinë dhe kulturën rumune”. Në vazhdim autori bënë fjalë për aktivitetin e Naum Veqilharxhit, duke i ndriçuar disa momente të reja nga jeta dhe aktiviteti i tij. Pastaj ai bënë fjalë edhe për Elena Gjiken dhe veprimtarinë e saj letrare, humaniste dhe patriotike, e cila me veprat e veta kontriboi në informimin e opinionit evropian lidhur me kërkesat

e popullit shqiptar. Këtu autori zë ngoje edhe lidhjet që ekzistonin midis kolonisë shqiptare në Itali, Greqi dhe asaj në Rumani lidhur me zhvillimin e kulturës dhe lëvizjes kulturore kombëtare deri në themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878.

Kapitulli i dytë, f. 81—168, bënë fjalë për organizimin dhe aktivitetin patriotik të kolonive shqiptare në Rumani, siç ishte themelimi i shoqërisë „Drita” e Bukureshtit. Këtu autori shënon se pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, reaksioni osman shkaktoi valë të reja mërgimi të shqiptarëve në kolonitë e Rumanisë dhe Bullgarisë. Duke bërë fjalë për revistën „Drita-Dituria”, e cila botohej në Stamboll ndihmoi në kultivimin e gjuhës shqipe me alfabetin e Stambollit, i cili do të shërbejë si bazë për hartimin e teksteve të para të shkollave shqipe.

Autori pastaj bënë fjalë për themelimin dhe aktivitetin e shoqërisë „Drita” në Bukuresht 1884, si degë e shoqërisë „Drita” të Stambollit, si dhe për mospajtimet që lindën në radhët e kësaj shoqërie në vitin 1886. Aty bënë fjalë për riorganizimin e kësaj shoqërie dhe hapjen e degëve të saj në Brailë dhe për botimin e gazetës „Shqiptari” 1888—1890. Këtu bëhet fjalë edhe për angazhimin e kolonive shqiptare në Rumani për hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë 1887, që kishte rëndësi të madhe historike në luftë kundër shko-mbëtarizimit të shqiptarëve nga kisha greke. Autori këtu bënë fjalë edhe për hapjen dhe aktivitetin e Shkollës së parë Normale shqipe në Bukuresht, në maj 1892, e cila do të ndihmojë në përgatitjen e kuadrit arsimor për shkollat që u hapën në rrethinën e Korçës. Në këtë mënyrë Bukureshti ishte shndërruar në një qendër arsimore, kulturore dhe politike të shqiptarëve.

Kapitulli i tretë që mban titullin: „Shoqëria kulturore „Dituria” e Bukureshtit”, f. 169—241, autori flet për kontributin që kjo shoqëri i dha Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që nga themelimi i saj në maj 1886 dhe e mori emrin e revistës „Dituria” që dikur botohej në Stamboll. Autori thekson se Shoqëria zhvilloi një ak-

tivitete të dukshëm kulturor dhe patriotik, duke e ngritur edhe shty-shkronjën e saj, ku më vonë do të shtypen librat e para të Sami e Naim Frashërit, Jani Vretos etj. Prej vitit 1894 „Dituria” formoi degët e saja në disa vende të Rumanisë, ku jetonin shqiptarët, kurse në vitin 1893 në Sofje u themelua shoqëria „Dëshira” që koordinonte punën me „Diturinë” e Bukureshtit.

Autori shënon me vend se gjatë viteve 1896/97 në Ballkan u bënë disa trazira, që i shqetësuan edhe shqiptarët, prandaj u paraqit nevoja për një gazetë shqipe, me qenë se „Shqiptari” i shoqërisë „Drita” dilte me ndërprerje. Prandaj shoqëria „Dituria” filloi të botojë gazetën e përjavshme „Shqipëria”, që filloi të botohej prej 10 majit të vitit 1897 deri më 31 dhjetor 1899. Këtu autori bënë fjalë për kontributin e kësaj gazete në zgjimin e vetëdijës kombëtare, si dhe në informimin e opinionit evropian mbi kërkesat e popullit shqiptar për njohjen e gjuhës shqipe, të kombit shqiptar dhe të drejtave për vetëqeverim. Sidomos këtu theksohet qëndrimi i shqiptarëve ndaj përpjekjeve të Fuqive të mëdha që me anë të disa reformave të kufizuara të ruanin status-quo-në në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane.

Në këtë kapitull, autori bënë fjalë edhe për gazetën „Yll'i Shqipërisë” që dilte në Bukuresht dhe për përpjekjet e diplomacisë ruse që të fusin ndikimin e vet në kolonitë shqiptare të Bukureshtit. Poashtu, autori flet edhe për përpjekjet e diplomacive të tjera evropiane e ballkanike që të infiltrohen në punën e kolonive shqiptare. Përmenden lidhjet që komitetet shqiptare nga Rumania mbanin me atdheun, e që më së miri e dëshmon edhe mbajtja e Kongresit të shqiptarëve të Bukureshtit më 1899, ku merrnin pjesë edhe delegatë nga vise të ndryshme të atdheut. Në atë kongres ishte hartuar një memorandum me të cilin kërkohej: 1. Autonomia e Shqipërisë; 2. Hapja e shkollave kombëtare; 3. Organizimi i milicisë kombëtare; 4. Bashkimi i katër vilajeteve; 5. Amnestia për refugjatët dhe të burgosurit për çështje kombëtare; 6. Të formohet Asambleja kombëtare

shqiptare; 7. Të ardhurat të prishën për nevoja të vendit; 8. Gjuha zyrtare të jenë shqipja dhe turqishtja. Autori në këtë kapitull bënë fjalë për themelimin e „Shoqërisë së studentëve shqiptarë në Bukuresht”, si dhe për përpjekjet e kolonive shqiptare për themelimin e kishës autoqefale shqiptare. Këtu bëhet fjalë për themelimin e degës së „Diturisë” në Konstancë, për hapjen e shkollës shqipe këtu dhe themelimin e shoqërisë „Djalëria shqiptare” në Brailë, gjë që dëshmon se në kolonitë shqiptare të Rumanisë zhvillohej një aktivitet i dendur në zhvillimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Kapitulli i katërt, f. 242—279, me titull: „Organizimi i kolonisë shqiptare në Bullgari dhe aktiviteti i shoqërisë „Dëshira” në Sofje deri më 1908”. Autori në hyrje të këtij kapitulli bënë fjalë se Bullgaria pas fitimit të pavarësisë u bë tërheqëse për ata që nuk pajtoheshin me pushtetin osman, dhe për ata që kërkonin punë, kështu që numri i shqiptarëve në Bullgari filloi të rritet. Në radhët e mërgimtarëve kishte punëtorë, zejtarë dhe tregtarë, që pjesa dërmuese e tyre ishin të përqëndruar në Sofje. Në mesin e tyre shpejt u paraqit nevoja për themelimin e një shoqërie. Natën e vitit të ri 1893 u mbajt mbledhja themeluese dhe shoqëria e tyre u pagëzua „Dëshira”. Kjo shoqëri, sikurse ato në Bukuresht kishin statutet dhe programet e tyre, ku parashihnin përhapjen e diturisë dhe mësimin në gjuhën shqipe, si dhe hapjen e shkollave shqipe në Shqipëri. Autori, po ashtu shënon se shoqëria „Dëshira” nuk kishte në radhët e saj intelektualë të lartë, por ata mbanin kontakte permanente me shoqëritë e Rumanisë dhe të Stambollit. Shoqëria „Dëshira” në këtë kohë i drejtoi Fuqive të Mëdha një memorandum në emër të popullit shqiptar, me të cilin kërkohej autonomia shqiptare. Ky memorandum kishte 10 pika ku radhiteshin kërkesat e popullit shqiptar.

Autori në këtë kapitull bënë fjalë edhe për themelimin e degës së sho-

qërisë „Dëshira” në Varnë në vitin 1908, si dhe për ngritjen e shtypshkronjës së „Dëshirës” në Sofje, ku u botua „Kalendari kombiar”, gazeta „Drita” e libra të ndryshëm. Autori bënë fjalë edhe për gazetën „Vetëtima”, që botohej në kuadrin e shoqërisë „Dëshira”. Kështu, pra ky kapitull pasqyron aktivitetin e kolonive shqiptare në Bullgari deri më 1908.

Kapitulli i pestë mban titullin: „Qendrimi i kolonive shqiptare në Rumani dhe Bullgari ndaj çështjes maqedone dhe reformat në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane”, f. 281—300. Në këtë kapitull autori jep një pasqyrë të shkurtër mbi qëndrimin e kolonive shqiptare ndaj çështjes së lartëpërmendur, duke theksuar se Lëvizja Kombëtare Shqiptare bënte përpjekje për bashkëpunim me lëvizjet e popujve fqinjë. Sa i përket reformave që duhej të zbatoheshin në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane në bazë të nenit 23 të Traktatit të Berlinit, Lëvizja Kombëtare Shqiptare i kundërshtoi, pse ato u kufizuan vetëm në Maqedoni e jo edhe për popujt tjerë. Me qenë se tokat e banuara me shqiptarë nuk përfshiheshin me reforma, shtetet fqinje ballkanike, filluan të shprehin aspiratat e tyre, duke fabrikuar shënime statistikore që të dëshmonin se ato kanë të drejta në këto treva. Shtypi balikanik dhe ai evropian filluan vijimisht të trumbetonin se shqiptarët janë të „egër”. Ata nuk dinë ç’janë reformat, ata duan të ruajnë gjendjen e vjetër etj. E gjithë kjo shfrytëzohej nga shtetet fqinjë, që të mund të veprojnë lirish në tokat e tyre, kërkonin nga Porta e Lartë çarmatimin e shqiptarëve.

Kapitulli i gjashtë titullohet: „Kolonitë shqiptare në Rumani e Bullgari në luftë për bashkimin kombëtar”, f. 301—333. Në këtë kapitull autori bënë fjalë për Kongresin pan-shqiptar në Bukuresht 1905, për formimin e „Komitetit për lirinë e Shqipërisë” në Manastir 1905, si dhe për aktivitetin e tyre. Po ashtu, bënë fjalë për bashkimin e shoqërive shqiptare në Rumani dhe për formimin e shoqërisë „Bashkimi” në korrik të vitit 1908, duke theksuar rëndësinë

e bashkimit të forcave shqiptare në vigjilën e Revolucionit xhonturk.

Kapitulli i shtatë me titull: „Aktiviteti i kolonive shqiptare në Rumani e Bullgari në periudhën 1908—1912”, f. 335—401. Në kapitullin e fundit autori shkruan për ndihmën e shoqërisë „Bashkimi” dhe të kolonive shqiptare në përgjithësi, që dhanë në themelimin e klubeve shqiptare në atdhe pas ngadhënjimit të Revolucionit xhonturk. Kjo ndihmë ishte shumë e vlefshme si nga aspekti i përvojës ashtu edhe nga aspekti i kuadrave, me qenë se shumë patriotë shqiptarë u kthyen në atdhe dhe u inkuadruan në aktivitetet kulturo-arsimor dhe politik. Kolonitë shqiptare ndihmuan edhe në mbajtjen e Kongresit të Manastirit, për aprovimin e alfabetit të përbashkët shqiptar. Autori këtu bënë fjalë edhe për kontributin e kolonive shqiptare në demaskimin e politikës shoviniste xhonturke ndaj shqiptarëve, duke e popullarizuar luftën e drejtë të shqiptarëve për autonomi. Në këtë kapitull bëhet fjalë edhe për përpjekjen e kolonive shqiptare në Rumani e Bullgari, për themelimin e kishës ortodokse autocefale për shqiptarët. Në këtë kapitull autori vendos edhe momentin vendimtar, kur Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi etj. erdhën në nëntor 1912, për t’u konsultuar dhe vendosën të shpallin pavarësinë e Shqipërisë, me këte edhe përfundon kapitulli.

Pas kësaj autori ka vendosur përfundimin në tri gjuhë, shqipe, serbo-kroate dhe anglishte f. 402—427. Në faqet 428—438 i ka vendosur burimet dhe literaturën e shfrytëzuar, që është mjaft e pasur dhe e shumëllojshme. Në f. 439 janë vendosur shkurtesat, kurse nga f. 441—452 është treguesi i emrave dhe i vendeve, e më në fund në f. 453—457 është vendosur pasqyra e lëndës.

Nga e gjithë kjo që u tha deri më tani, mund të përfundojmë se Ismet Dërmaku, ka bërë një studim serioz, si nga aspekti i trajtimit të një problemi jo mjaft të përpunuar, ashtu edhe nga mënyra e interpretimit të ngjarjeve në mënyrë shkencore, duke i vështruar me një sy kritik burimet dhe literaturën e shfrytëzuar. Po ashtu edhe nga aspekti

metodologjik dhe teknik, studimi është i plotë dhe për lavdëratë. Me këtë, lexuesit i ofrohet një studim i mirë, i kuptueshëm, kurse historio-

grafia shqiptare begatohet edhe me një vepër historike mjaft të rëndësishme.

SHUKRI RAHIMI
Fakulteti filozofik, Prishtinë

Aleksandër Stipçeviq, SIMBOLET E KULTIT TE ILIRËT, Rilindja, Prishtinë 1983, 243

Duke marrë parasysh kontributin e përgjithshëm që i ka dhënë shkencës mbi ilirët, Aleksandër Stipçeviq konsiderohet njëri ndër ilirologët më të dalluar bashkëkohor jugosllavë dhe evropianë. Libri i parë me këtë tematikë ishte „Arti degli Illiri”, i botuar në Milano me 1963, ndërsa i fundit „Kultni simboli kod Ilira” që e kemi tani të përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

Libri „Simbolet e kultit te ilirët” përbëhet nga tre kapituj dhe është i ilustruar me 36 tabela dhe 8 harta. Qëllimi i autorit ishte që të japë një pasqyrë të tërësishme mbi një lami e cila deri më tani nuk është trajtuar në literaturën shkencore në mënyrë të tërësishme — mbi simbolet e kultit. Në krijimin e kësaj vepre autori është mbështetur pothuaj terësisht në materialin arkeologjik, i cili është më i pasur, ndërsa burimet historike dhe ato mitologjike janë tejet të pakta.

Në kapitullin e parë autori shqyrton strukturën e simbolizmit ilir, të cilin e ndan në disa grupe globale.

Ornamentika gjeometrike te ilirët paraqitet në masë të njëjtë si në periudhën parahistorike ashtu edhe në kohën e sundimit romak. Pos domethënies thjesht dekorative këto simbole kishin edhe domethënie religjioze. Simbole më të popullarizuara religjioze të këtij grupi ishin: *spiralja*, *spiralja e dyfishtë*, *meandri*, *vija valore* dhe *vija zig-zag*. Spiralja si simbol themelor i këtij grupi paraqitet në kulturat e ndryshme qysh nga paleolitiku i ri. Në territorin ilir ajo arriti popullaritet më të madh gjatë epokës së hekurit.

Sa u përket simboleve *solare* dhe *lunare*, ato gjenden në objekte të llojllojshme të destinimit laik dhe religjioz. Simbole më të shpeshta ko-

nsiderohen: *disku*, *rrethi*, *rrathët koncentrikë*, *svastika*, *shenji „S”*, *kryqi*, *dreri*, *shpezët moçalike* etj. Një gjë rrallë e shkruar mbi simbolizmin ilir ka të bëjë pikërisht me simbolin solar dhe gjendet te Maksim Tiri (Maximus Tyr) në sh. II p. e. s. Simboli më i popullarizuar i këtij grupi, *svastika*, të parën herë u shfaq në periudhën e neolitikut dhe konsiderohet një ndër simbolet më të lashta indo-europiane dhe paraqitet në hapsirat e gjera evropiane në epokat e neolitikit dhe të hekurit. Domethënia themelore e këtij simboli ishte solare, por ai kishte edhe domethënie të tjera, të cilat deri më tani nuk janë analizuar në masë të mjaftueshme. Vlen të theksohet se te ilirët ishte e njohur edhe varianta e dytë e këtij simboli-svastika me gjemba të kthyer (suavastika), simbol që gjendet edhe në Indinë e lashtë.

Sikur të gjithë popujt e lashtë ashtu edhe ilirët besonin në ekzistimin e botës nëntokësore. Në lidhje me këtë ata formuan një sistem të tërë shenjash që e simbolizonin këtë botë. Nga simbolet htonike te ilirët ai i gjarpërit kishte rëndësi universale. Paraqitjet më të hershme figurative të këtij simboli datojnë nga epoka e hershme e neolitikut, kurse më së miri është dëshmuar në lokalitetin Lepenski vir. Në trevën ilire ky simbol zakonisht paraqitet në dy forma, në atë realistike dhe në formën e stilizuar apo gjeometrike. Me ardhjen e keltëve në Ballkan intensifikohet përdorimi i këtij simboli te popullsia vendëse, gjë të cilën autori e shpjegon me dëshirën e elementit etnik ilir që ta theksojë identitetin e vet nacional. Gjatë sundimit romak kulti i gjarpërit mbeti edhe mëtej dominant e kjo vlen edhe për shekujt e parë të krishtenizmit.